



NACIONAL

Gazetë javore, letrare & kulturore, e përditshme online


Drejtori: Mujë Buçpapaj
e-mail: bucpapaj@yahoo.com**Mobi:** 068 20 74 316**www.gazeta-nacional.com****Adresa:** Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
e-mail: nacionalalbania@yahoo.com

Prej dhëmbjes dhe trishtimit

Botohet në Itali libri poetik i Visar Zhitit "Nata është atdheu im"

Nga Ennio GRASSI


faqe 17



Flet për Nacional poetesha gjimnaziste nga Lushnja

Oriada Sulo: Poezitë e librit tim pikojnë trishtim

faqe 3



EDITORIAL

PËRCJELLJA E ETNOKULTURËS ILIRE TE SHQIPTARËT

Nga Prof. Dr. Sazan GURI

Le të kthehemi te gjuha e këtij populli dhe librat e tij apo liria dhe drejtësia për të mbajtur gjallë misionin e ngarkuar me anë të gjuhës e dokeve. Perandoria turke e mendonte shtypshkrimin



Faqe 14

SHKRIMTARI I TRILLIT, KY MASHTRUES I PAFAJSHËM

Nga Zija Çela

1. Do të kisha dashur t'i bëja disa pyetje Mehmet Krajës për katër romanet e ribotuara nga Onufri: "Edhe të çmendurit fluturojnë" (2004), "Im atë donte Adolfin" (2005), "Selvitë e Tivarit" ("2007) dhe "Hotel Arbëria" (2010). Do të doja ta pyesja, për



Faqe 7

Nikaj solli në letërsinë shqiptare tipin e romanit historik e patriotik

Si vdiq në burgjet komuniste babai i romanit shqiptar dom Ndoc Nikaj

Nga DEA KARAKAÇI

faqe 8

VEPRIMTARI I SHQUAR I ÇËSHTJES SHQIPTARE NË SHBA VIJON RRËFIMIN E TIJ PËR TAKIMIN E RUGOVËS NË SHTËPINË E BARDHË DHE AMBASADORIN HOLLBROOK



SABIT BYTYÇI: HOLLBRUK MË THA SE MILLOSHEVIÇI PINTE NË ZYRËN E TIJ KONJAK DHE PURO

Intervistoi: Mujë Buçpapaj

110 vjet nga "Gramatika e Gjuhës Shqipe" e Dr. Gjergj Pekmezit në Vjenë

NGA HAZIR MEHMETI

Përtej ngushëllimit të Artistes së Popullit Tinka Kurti për shkrimtaren Flutura Açka

NGA HIQMET ZANE

NËBRENDËSI

Edukimi në kontekstet e kohës postmoderne

Nga FRAN GJOKA



FAQE 2



Ne ishim tri...

Tregim nga Kristina Demiri

FAQE 8

Thashethemxhiu

Poezi satirike nga Hasan Buçpapaj



FAQE 22



KËNDO MOJ ERË

Lirika nga Mustafa SPAHIU

FAQE 6

Therrmim ankthesh

Poezi nga Visar Mborja

FAQE 4-22

Prozë nga:

FATBARDH RUSTEMI
ENRIETA SINA

FAQE 6-21



www.radioliberal.al

BRILLIANT

HOTEL & SPA

Objekt banimi dhe dy kata shërbimesh
Adresa: Buzë rrugës "5 Maj", 350 metra nga unaza

Kontakt

+355 068 2023 410/ +355 068 20 60 154 S.S.X shpk

Mrekullia e natyrës shqiptare



Flet për Nacional poetesha gjimnaziste nga Lushnja

Oriada Sulo: Poezitë e librit tim pikojnë trishtim

Oriada, sapo keni botuar librin e parë me poezi. Cfarë është ky moment në jeten tuaj dhe në krijimtarine tuaj?

-Ky libër me poezi shënon hapin e parë për mua drejt ndërtimit të një personaliteti në adoleshencë, pasi jam vetëm një gjimnaziste 16 vjeçe. Pikërisht ky çast në botëkuptimin tim shënon ciklin ku njeriut i takon që të marrë në dorë frerët e jetës së tij.

-Cilat kanë qënë emocionet që kanë prodhuar këtë libër?

-Poezitë e librit i përkojnë trishtimit. Është ky emocion, i cili nuk u mungon lexuesve në asnjë gërmë të zezë në të bardhë. Secila poezi është shkruar në emocionin momental. Kur kam ndërje një dashuri më të fortë se e zakonshmja për nënën, me shpejtësi i kam shkruar vargje ç'më fluturonin në mendje. Kur kam ndërje një dashuri universale, kam shpejtuar për të shkruar vargjet e tjera. Një lidhje zinxhir e atillë ka ndodhur me të gjithë poezitë e tjera.

Për të mos lëne pas, duhet përmendur që shtysa më e madhe për daljen në dritë të këtij libri ka qënë dy dashuritë e mëdha, nëna dhe gjyshja im, që prehet e qetë.

-Cfarë synimmesh keni në poezi dhe letërsi, cila është ëndërra juaj e madhe?

-Momentalisht synimi më i madh është që të gjej gjithmonë veten brënda letërsisë, poezisë dhe vargut. Do të ishte dicka e madhe dhe universale të isha vërtet një ditë një "Poete."

- A keni poetë të preferuar apo shkrimtarë, cilet janë ata?

-Sigurisht që po, kam autorë të ndryshëm të mirënjohur që i shfletoj çdo ditë kohës së lirë.

Poetë të rinj që i lexoj shumë gjithashtu janë Marjeta Çurumi dhe Anila Toni që kam pasur fatin e madh t'iu njoh shkrimin dhe shpirtin e bukur.

-Si e organizon jetën një gjimnaziste e vitit të parë, sa ju lejon ngarkesa mësimore të merreni me letërsinë?

-Është paksa e vështirë, pasi gjimnazi ka ngarkesë të lartë mësimore. Nga një anë është letërsia mësimore që nuk duhet lënë pas dore dhe nga një anë është letërsia shpirtërore që nëse të mbërthen, nuk i ndahet lapsi nga dora.

-Kë do të falenderoni për mbështetjen që ju kanë dhënë për botimin e këtij libri ?

-Ky është një falenderim prej kohësh që qëndron i fshehur sirtarit tim të ndjenjave. Faleminderit gazetarit Agron Mema që nuk hezitoi kurrë të më ndihmonte, që tregoi mirësjelljen e tij, që zuri vendin e nje babai të dytë tek unë. Marjeta Çurumi mësuesja që më drejtoi udhës së errët të hapave të parë krijues. Eisa Xhaferri, mësuesja e letërsisë në 9-vjeçare, një femër si fëmijë i pastër në shpirt,

që më mbështeti, qoftë dhe me buzëqeshjen, mimikën e saj ëngjëlllore që më dhuronte çdo ditë. Enkelejda Dushku, dora ndihmëse e hapave të parë shkollorë që s'resht së më shtuari besimin në vetvete sa herë e takoj dhe sa herë ajo grua më bën të kuptoj çështje respekti për njerëzit. Faleminderit poetit Sinan Kërpaçi, për mbështetjen emocionale dhe këshillat e tij profesionale dhe dashamirëse.


Shtëpisë Botuese ku u botua dhe libri i shkon një falenderim special ndër to pjesë e stafit Xhina Palko dhe drejtuesi zemërfisniku shkrimtari M ujo Buçpapaj, drejtor i gazetës prestigjioze të letërsisë". Faleminderit "Nacional"! Gjithë stafit të shkollës 9-vjeçare"Xhorxh Soros" me në krye të mrekullueshmen Nertila Proshka dhe gjimnazit "18 Tetori" me drejtorin më të përkushtuar, që di të zgjidhë çdo gjë me qetësi dhe mirëkuptim, Leonard Greku.Faleminderit!

E fundit i takon mirënjohje dhe jo vetëm familjes time. Nënës Zenepe Sula, babait tim të cmuar Myfit Sula dhe vëllait që janë shembulli më i drejtë në këtë botë me plot vështirësi...

Ata janë mbështetës të veprave tona,



Oriada Sula



pajtimtarë të mendimeve tona, ndihmë e pakursyer dhe dashuri e pafundme. Sido qofshin, ata më bëjnë gjithmonë ta ngre kokën me krenari prej vlerave që i marr dita-ditës prej tyre.

-Ndonjë projekt tjetër letrar ?
-Jam në nisjen e një libri tjetër me poezi.
-Po në prozë a keni ndonjë impuls?
-Për sa i përket prozës shkruaj ndonjëherë por nuk e di nëse do arrij daljen e një vëllimi me tregime. Por, nuk i dihet asnjëherë.
Cfarë keni tjetër për të shtuar?
-Ju falenderoj juve për intervistën.

Intervistë me poetin dhe gazetarin Ndrek Gjini

Koha nuk është thjesht një datë në kalendar

Zakonisht, njohje të tilla lidhen me gjëra shumë praktike por këtu rrëfimi i gjyshes e bën poetin dhe lexuesin ta shikojë më nga afër ngjarjen apo ndodhinë e treguar.

Kalendar

Gjyshja ime përdorte një kalendar të vërtetë, domethënë, sipas ngjarjeve.

“Ti pate lindur katër hëna pas përmbytjes së madhe kur vdiqën gjysma e qytetit, dymbëdhjetë hëna pasi komunistët hodhën në erë kishën. Linde vetëm dy hëna pasi që pjekur rrushi,” më tregonte ajo.

Si fëmijë, para se të shkoja në shkollë unë nuk dija asgjë për faktin se qeshë lindur më 1 Tetor 1963.

Nëse ju them datën e lindjes time sipas kalendarit të tanishëm nuk ju them asgjë për veten. Po, çfarë nëse unë përdor kalendarin e sime gjysheje?

Intervistë:

Ka një ndjesi sikur jeta që bëhej dikur ka patur më shumë gjallëri sesa kjo aktuale apo moderne. Ne ç'mënyrë mendoni ju, jeta e sotme moderne ka ndikuar tek poezia?

Ndrek Gjini: Bota ka ndryshuar shumë nga ajo që ishte në rininë time në vitet 1970. Ndryshimet e mëdha në fushën e teknologjisë dhe komunikimit i kanë dhënë fund mënyrës tradicionale të jetesës, e cila ka qenë statike për shumë breza. Pa dalë fare nga dera e shtëpisë, ne tani mund të shohim dhe të dëgjojmë rreth ngjarjeve që sapo ndodhin në pothuajse çdo pjesë të botës. Pajisjet dhe mjetet e reja teknologjike kanë sjellë më shumë argëtim dhe “kohë të lirë” dhe e gjitha kjo ka ndodhur brenda harkut kohor të një brezi. Këto ndryshime kanë ndikuar në gjithë mënyrën e të menduarit tonë, në mënyrën e të shkruarit gjithashtu, përfshirë edhe poezinë. Megjithatë, pavarësisht nga lehtësirat dhe kënaqësia që na sjellin këto ndryshime, ato kanë shkatërruar shumë nga zakonet tradicionale të jetesës. Bashkëbisedimi i çiltër në shtëpi mes anetarëve të familjes, madje edhe me fqinjët, mbrëmjeve pranë zjarrit, pa Radio, TV, Laptop, Iphone apo iPad ka marrë fund tashmë. Do të thoja se këto lloj bisedash ishin më interesante sesa aktivitetet e leximit të poezive në pabet e Galluejt, Londrës apo Nju Jorkut ku secili pretendon se po dëgjon ndërsa rri duke dërguar mesazhe apo duke postuar statuse në facebook ose twitter gjithë kohën.

Koha pothuajse gjithnjë paraqitet si një mjet gjuhësor në poezinë tuaj ku njerëz të ndryshëm e masin atë në mënyra të ndryshme,. A shikoni ndonjë lidhje mes kohës dhe gjuhës, në mënyrën e të shkruarit të përgjithshëm dhe specifik?

Ndrek Gjini: Për t'iu përgjigjur pyetjes suaj, së pari do të thoja se që në kohën që njerëzit për herë të parë vunë

rë lëvizjen e rregullt të diellit dhe yjeve, kanë filluar ta vrasin mendjen rreth kalimit të kohës. Njerëzit parahistorikë masnin fazat e lëvizjes së hënës rreth 30 000 vjet më parë. Matja e kohës ka qenë një mënyrë përmes së cilës shoqëritë kanë vëzhguar qiejt dhe kjo tregon edhe progresin e qytetërimit.

Së dyti, do të thoja se duhet ta kuptojmë se koha nuk është thjesht një datë në kalendar; ajo është një ndjesi, ngjarje, ndodhi. Edhe gjuha si mjet i të shprehurit është e tillë. Kështu që çdo ndryshim që sjellin këto ngjarje në mënyrën tonë të jetesës, pasqyrohet edhe në gjuhë gjithashtu.

Anëtarët e familjes tuaj jane karaktere që shfaqen shpesh në përmbledhjen tuaj “Vdekja e Natës” siç ndodh edhe në këtë poezi. Përveçse si karaktere në poezitë tuaja, a kane ndikuar ata në shkrimet tuaja në ndonjë mënyrë tjetër?

Ndrek Gjini: Po, nëna ime, ajo ishte një grua e qetë dhe e ndrojtur. Kur isha i vogël e dëgjoja atë shpesh duke recituar poezi kur ajo lutej. Lutjet në shqip kanë shumë muzikalitet dhe rimë. Në atë kohë, unë nuk dija gjë për kuptimin e tyre por unë i doja vjershat dhe kështu erdhi edhe pasioni im për poezinë.

Perse shkruan?

Ndrek Gjini: Nuk mund ta imagjinosh sa e sa herë ia kam bërë vetes këtë pyetje deri në momentin që vendosa të shkruaj një poezi për të ku them: “Unë linda në një qytet pa heronj / Jo fort i zoti për të luftuar / dhe për këtë shkruaj.”

Nëse do të kishit ndonjë këshillë për një shkrimtar, çfarë do të ishte?

Ndrek Gjini: Më fal por nuk kam. Nuk e di se pse e kemi kaq të vështirë ta pranojmë idenë se talenti nuk është thjesht nje dhuratë nga Zoti, por një zeje që mësohet duke punuar me mijëra e mijëra orë. Ka shume aforizma rreth të shkruarit; dua të kujtoj vetëm dy prej tyre. “Shkrimi eshte rishkrim” dhe “Nuk mund të mësosh dikë sesi të shkruajë”



Nga Trevor Conway, kryeredaktor i revistës irlandeze “Poems in Profile”

Hyrje

Poezia e Ndrek Gjinit duket në pamje të parë e thjeshtë. Ajo e tërheq lexuesin në një mënyrë shumë të drejtpërdrejtë, me referenca për komunizmin, rakinë e rrushit dhe gjyshen e folësit. Por kjo poezi ka një gjë tjetër që është më abstrakte. Nënkuptimi i përdorimit nga folësi i një kalendarit personal është se vetë nocioni i kohës është trillim, një konstrukt që ne e kemi krijuar siç kemi dashur vetë.

Në fakt, “trillimi” i folësit është “i vërtetë” dhe “domethënë”. Ai/ajo refuzon konvencionin në formën e kalendarit të përgjithshëm. Mbase ne të gjithë operojmë përmes kalendarëve të tillë personalë. Kur i shikojmë fotografitë, ne nuk themi “Ishte 3 gushti i vitit 1993”. Ne mund të themi “Ishte dita kur ne shkuam për piknik”. Apo 9/11 na ngjall imazhet e një ngjarje me shumë sesa vetë datën. Dhe shumë prej nesh kujtojmë ku ishim kur kanë ndodhur ngjarje të tilla të rëndësishme duke i lidhur përvojat tona të vogla jetësore me ndodhi të tilla globale.

Kalendarit konvencional me të gjithë shenjat e tij dhe numrat është gjithashtu i lidhur me ngjarje të tilla si rrotullimi i tokës rreth vetes, fazat e rrotullimit të hënës dhe rrotullimi i tokës përreth diellit. Ne instiktivisht shikojmë përtej këtij planeti për të kuptuar dicka më të madhe dhe abstrakte siç është koha. Në të njëjtën kohë, ne mësojmë nga bashkëkohësit dhe familjet tona siç bën poeti këtu.